



KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL X/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 10 (dhjetë) për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 28.10.2022
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi
Rexhepaj
Znj.Mimoza
Bajrakatari
Znj.Fidaije Kukaj
Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë

Znj.Saranda Bajraktari
Z. Driton Maliqaj
Z. Xhevxhet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Qëndrim Elshani
Znj.Festë Kabashi
Z.Herolind Limaj
Znj. Jehona Rrafshi

Kryetari i Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për lirimin nga pagesa e shërbimeve mjekësore “Mamografisë” ;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të ndërhyrjes ndër-sektoriale për ndryshime klimatike për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2028;
5. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Shator 2022;
6. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - i njofton të pranishmit që ka një pikë shtesë e cila ka të bëjë me ndryshimin e vendimit të Hartës Zonale.Kërkohet nga ministria që të hiqet Zona Industriale dhe Agrozona nga vendimi dhe për elaborim më të gjerë fjalën ia jep zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - në konsultim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me kompaninë kemi ardh në përfundim që Zonën Industriale dhe Agrozonën ti përfshijmë në Hartë Zonale. Mirëpo ministria konsideron që këto dy zona nuk duhet të jenë të përfshira në Hartë Zonale dhe kërkon që ti shfuqizojmë. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime shtesë.

Laurtea Tafaj - pe heqim sot. A do të thotë që pas dy jave keni me bisedu me ministrinë dhe keni mi sjellë prap mi fuqizu,apo mbesin përgjithmonë të hequra?

Avni Bytyqi - jep përgjigje.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

25 për,1 apstenim
Miratohet Pika shtesë

Kryesuesi - i njofton të pranishmit se ka dhe një pikë shtesë nga grupi parlamentar i LDK-së.Kërkesa ka të bëjë me vendosjen e shtatores së Dr. Ibrahim Rugovës në shesh.Ne kemi respekt për figurën e Ibrahim Rugovës,mirëpo në planin rregullativ nuk është parapa me pas shtatore në shesh.

Selman Kolgeci - Ju më keni thënë për rregullore të Kuvendit,jo për planifikim.As shtatorja e Ibrahim Rugovës e as shtoretet tjera nuk janë të detalizune as në Harta Zonale e as kurgja tjetër.Andaj unë kërkoj të votohet.Kjo nuk ka të bëjë me procedura.

Kryesuesi - ju e dini që sheshi e ka emrin Ibrahim Rugova.Kemi pas dhe kërkesa tjera për shtatore në shesh.Prej urës së madhe e deri te Podrumi e gëzon emrin e ish presidentit Ibrahim Rugova.

Dardan Berisha - me sa e di është duke u hartu një rregullore për sheshet.Ka dhjetë vjet që shtatorja e Adem Jasharit ka pas kalu dhe nuk është vendos në qytetin e Suharekës.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

11 për,13 kundër,3 apstenime
Nuk Miratohet pika shtesë

Shefket Kolgeci - ju keni qasje shumë të gabuar.Unë pe shoh një frikë të pushtetit që një pikë të rendit të ditës opozita e propozon dhe pozita nuk e miraton.Kjo është antidemokratike.Nuk di me çfarë logjike mos me hy kjo pikë në rend dite për me u diskutu.Për mua kjo është e pa pranueshme.

Aziz Bytyqi - kjo pikë nuk është me urgjencë.E kuptoj edhe emocionin tënd në një farë mase,sepse ka emocion për figurën emblematike të popullit shqiptar.Nuk ka vend për politikë.Një plan rregullativ ku bazohet në infrastrukture ligjore nuk po lejojka.Sheshi është,emrin e gëzon dhe kjo pikë mundet me kalu në seancat e ardhshme në mënyrë të rregullt.Të gjithë kemi respekt për figurën e Dr.Ibrahim Rugovës dhe këtë e kemi dëshmu në kontinuitet besoj dhe s'është koha sot me dëshmu as afërsi,as dashuri,as injorim.

Shefket Kolgeci - nëse i ke veprimet kundër me fjalë dhe çka mendon,unë atë nuk e di.Unë i cilësoj veprimet.

Selman Kolgeci - unë dua të ndërlihem me Azizin ku tha që kemi respekt.Për respekt u pa vota kundër vendosjes së shtatores.A ka mundësi Aziz me ma dokumentu kush ta kundërshton me vendos shtatoren?

Aziz Bytyqi - në bazë të njerëzve kompetent,në shesh nuk është parapa me pas shtatore.Për me ardh te kjo fazë duhet me u ndryshu ajo rregullativë.

Selman Kolgeci - në shesh nuk është parapa as rrugë por e keni bo.

Dardan Berisha - sa i përket rrugës së sheshit ne e kemi kalu në Kuvend,me sa e di.Vet fakti që thotë që po bëni politikë,edhe ky vendim është puro politikë.

Driton Maliqaj - këto reagime pikërisht janë politike.Me të tëra vite e keni pas sheshin.Nuk ka qenë i rregullun por ka pas kënd të sheshit.Pse nuk e keni votu në kohën kur keni qenë në pushtet?Pse se keni ngrit shtatoren e dr.Ibrahim Rugovës?Shtatorja e të madhit Adem Jashari,pse qe sa vite nuk u bë.Sot po nxitni debate puro politike dhe po na qitni në situata të pa lakmueshme.

Shefket Kolgeci - a ka ardhë propozimi për shtatoren e Adem Jasharit ndonjëherë?Bjere dhe testojte LDK-në a po voton pro apo jo.Sheshi nuk ka qenë atëherë.Tani e ka emrin sheshi Ibrahim Rugova dhe i përket me pas një shtatore.Nuk jemi duke bë politikë.

Selman Kolgeci - Dardan po thua që ka kalu në Asamble çështja e rrugës.Citon postimin e fundit të Kryetarit për sheshin.Nuk keni marrë miratim as prej Asamblesë,as prej kompanisë projektuese e as prej qytetarëve.Driton nuk e di çfarë situatë e palakmueshme është vetëm me fut në rend dite për diskutim çështjen e vendosjes së shtatores së presidentit Ibrahim Rugova në shesh.

Laureta Tafaj - shpeshherë them që jemi me fat që nuk kemi transmetim direkt nëpër media,për me na dëgju fëmijët çfarë niveli të diskutimit jemi duke bërë në Kuvend.Ju lutem,ose votone ose mos e votoni por mos bini në lajthitje me i keqpërdor emrat e atyre njerëzve të cilët kanë dhënë shumë për këtë vend. **Dardan Berisha** - sa i përket rrugës,ndoshta jam gabim por e kemi votu në sezon.Ai vendim a duhet me ardh prap në Asamble,me shfuqizu dhe me bo një korsi? Ka kalu dy korsi dhe ashtu ka mbet.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me një pike shtesë.

14 për,1 kundër,11 apstenime
Miratohet rendi i ditës me një pikë shtesë

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e parë.

Unanimisht Miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - për këtë temë kemi diskutu edhe në fillim ku e kemi dhënë përqimin që me u ndjek procedurat dhe mendoj që është mire prap të jepet pëlqimi që Arta tex me vazhdu aktivitetin e vet. Te neni nr.1 shkruan që kjo jepet për 35 vjet dhe neni nr.2 datat janë që kjo jepet për 99 vjet. Është mire këtë gabim te neni nr.2 me ndryshu.

Kryesuesi - është gabim teknik dhe do ta përmirësojmë.

Kryesuesi - e hedh në votim me vërejtjen që e dha Urim Suka.

20 për, Miratohet Pika 2.

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për lirimin nga pagesa e shërbimeve mjekësore “Mamografisë”

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që personalisht e përkrah këtë ide që kjo kategori të lirohet nga pagesa.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përshëndet të pranishmit. Falemderoj secilën asambleiste të cilat përtej kahjeve politike po mbledhemi bashkë dhe po diskutojmë dhe po ngrisim kauza të rëndësishme. Falemderoj edhe anëtarët KPF-së për mbështetjen unanime të kësaj pike për Asamble. Jemi në muajin tetor dhe ky muaj njihet si muaji rozë i cili shërben që me organizu sa ma shumë fushata dhe aktivitete vetëdijësuese për vetëdijësim kundër kancerit të gjirit. Kjo sëmundje po merr jetën e miliona njerëzve dhe sidomos grave. Diagnostifikimi i hershëm po shpëton jetë dhe për këtë arsye e kemi marrë këtë iniciativë. Të nderuar asambleist ju ftoj secilin që ta mbështetni këtë pikë dhe ta shënojmë tetorin rozë me veprime dhe vendime konkrete.

Urim Suka - ne si grup i LDK-së e kemi trajtu këtë temë dhe e kanë mbështetjen maksimale grupi i grave dhe i falemderojmë për punën dhe angazhimin që gjatë kësaj legjislature kanë. Mbështetjen grupit të grave për këtë iniciativë i japim edhe me votë në Kuvend sot. Kërkoj sqarime nga Drejtoresha e Shëndetësisë nëse kapacitetet e QKMF-së janë për ti përballu këto dhe nëse aparatura që QKMF-ja ka, fotografimet dhe inqizimet të dalin sa ma kualitative dhe nëse QKMF-ja ka mungesë në këtë drejtim, e rekomandojmë Drejtoreshën që të bëjë të gjitha kërkesat e nevojshme dhe ne do ti mbështesim edhe kërkesat shitesë nëse nevoiten për aparaturë më moderne. E mbështesim edhe iniciativën që me punu me orar të plotë.

Bajram Basha - përshëndet të pranishmit. Duke e pa rritjen e numrit të pacientëve që diagnostifikohen me karcinom të gjirit, krizën e kostos së jetesës dhe inflacionit të lartë, e shofim të arsyeshme që mamografia të ofrohet falas në shërbimin e Radiologjisë në QKMF Suharekë. Në emër të grupit parlamentar jemi pro propozimit për lirimin nga pagesa. Sa i përket propozimit të Sanies, aty duhet të jenë 3 radiolog sepse problem është vetëm me një radiolog.

Shefket Kolgeci - e përkrahim këtë iniciativë por kërkoj që të jetë në funksion ai aparat. Mos të ndodh që pacientët me u kthy me arsyetimin që s'ka film dhe të shkojnë privat. Është një kohë e vështirë nga ana çështjes materiale dhe ka njerëz që janë keq materialisht andaj sidomos atyre duhet me iu dal ndihmë.

Laureta Tafaj - gjatë vizitave tona që i kemi bo, një ditë kemi qenë në QKMF dhe kemi pa mamografinë aty kemi has që punojnë vetëm tre teknikë, gjë që është shumë e lodhshme me i bo nga 8 apo 9-të mamografi të cilat janë duke i bo tash për momentin. Ne kemi dalë me disa kërkesa por që sot nuk kemi dasht me i thanë, por kërkesa shumë e madhe është që me qenë edhe disa teknik tjerë të radiologjisë sepse radiologu nuk është duke punu. Mamografinë gratë e marrin dhe raportin duhet ta lexojnë privat, pra është një punë gjysmake. Andaj kërkesa jonë është që të fuqizohet më shumë radiologjia në QKMF.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ne si grup i grave kemi bo rekomandim dhe na është thënë që mamografi po punon çdo ditë pune, gjë që i falemderoj Drejtorinë e Shëndetësisë.

Besa Kuçi - përshëndet të pranishmit. Falemderoj grupin e grave të Kuvendit Komunal. Në QKMF Suharekë radiologjia në anën e mamografisë nuk ka punu çdo ditë për shkak se mamografi dhe rentgeni kanë qenë me një vend. Në kuadër të projekteve kapitale drejtoria e Shëndetësisë e ka parapa këtë pjesë me nda dhe kjo është bërë këtë muaj dhe rentgeni punon veq dhe mamografi veq në objektin tjetër. Ju lus të keni parasysh edhe punëtorët shëndetësor të cilët rrezatohen çdo ditë. Ju kisha lut që kjo të bëhet me termine, sepse ambientit i duhet 15 min ajrosja. Mamografi është funksional dhe ne jemi në bisedime me

projektin AQH për mirëmbajtje të teknologjisë dhe besojmë që prej AQH -së kemi me marrë aprovimin e këtij projekti.Sa i përket kapacitet për momentin janë duke punu tre teknikë të radiologjisë dhe nëse ka nevojë do të angazhojmë staf shtesë.Për momentin radiologun nuk e kemi për shkak se është duke e ndjek një trajnim për leximin e mamografisë dhe besoj që do të kthehet sapo ta përfundoj trajnimin.

Shpresojmë që në të ardhmen me i funksionalizu edhe më shumë shërbimet tona.

Urim Suka - ne vazhdojmë me mbështetjen si ide që me qenë falas por vazhdojmë që ato shqetësime që unë ngrita dhe me plotësimet që bëri doktorri dhe me përgjigjen që mora nga drejtoresha,vazhdoj me e kuptu edhe më mire që ju shpeshëherë po merrni vendime të shpejta,të paanalizuara dhe që duket që ka me pas vështirësi në implementim.Ju rekomandoj drejtoreshë që të merrni të gjitha veprimet e nevojshme që kapaciteti i këtij shërbimi me qenë i plotë dhe me u mbrojtë shëndeti i punëtorit.Nëse ka nevojë le të bëhen edhe aparatura plus.Merri veprimet që duhen se ke me pas mbështetjen tone që kjo mos të jetë vendim në letër por le t'është vendim që funksionon.

Besa Kuçi - pikërisht për mos me ndodhë këto probleme kur na sillen vendimet prej Asamblesë të cilat bëhen të nxitume nganjëherë dhe hasim në lajthitje në zbatimin e tyre,pikërisht kërkova që me cek,me u bë me termine.Kemi pas kërkesa të mëdhaja dhe kanë ardhë brenda ores 7 ose 8 pacientë,ku 7 ose 8 nuk është e mundur të kryhen,siq e ceka dhe më herët.

Laureta Tafaj - pajtohem me drejtoreshën se duhet me pas termine.Nuk mundemi ne duke e shpëtu jetën e dikujt me rreziku jetën e dikujt tjetër,sepse ata punëtorë nuk mundën me i kry 30 mamografi në ditë.

Alban Berisha - përshëndes grupin e grave për këtë punë që e kanë bo.Në një formë direkte apo indirekte gati secili prej nesh në rrethin e ngushtë apo më të gjërë jemi të prekur me një anëtar të familjes dhe kjo si masë,është një masë preventive që sa ma herët që zbulohet mundësia e shërimit është më e madhe. Ne si Suharekë, më shumë vendbanime kemi në vise malore ose në fshatra se në qytet.Zakonisht unë hallin më të madh e kam se a e keni mendu si grup edhe strategjinë e informimit të grave mbi 40 vjeqare,kurse sa i përket punës së termineve,unë mendoj që më mire është të punohet me termine.Vetëm informimin ne e kemi të dobët në komunën e Suharekës.

Saranda Bajraktari - personalisht po ndihem mire sepse një rekomandim të tillë e kam dhënë vazhdimisht te grupi i grave.Jam për çështjen e termineve sepse terminet duhet me u respektu,mirëpo terminet jo me zgjatë 3 deri 6 muaj duke e ditë rëndësinë e parandalimit të kësaj sëmundje,gjë që kam raste të familjarëve që kanë prit po kaq muaj.Ndërsa çështja se si kemi me kriju lloj të komunikimit,është komunikimi personal ose mundemi me kriju ligjerata vetëdijësuese ose komunikim qoftë përmes Kryqit të Kuq ose organizatave tjera.

Shefket Kolgeci - te çështja e procedurave të tenderimit,por një udhëheqës i mire nuk duhet të jetë pa filma sepse atyre filmave nuk ju skadon afati.Merrni një rezerve të filamve që pacienti mos të kthehet.

Nënkryetarja - përshëndet të pranishmit.Vërtetë është një pikë që nuk duhet të diskutohet vetëm një here në vit por është një pikë për të cilën duhet të flitet çdo ditë.Mua më gëzon fakti i gjithë grupit të grave asambleiste që kur është çështja dhe kur flitet për gratë,janë bashkarisht dhe nuk njohin partitë politike.

Falemderoj gr. e grave dhe Drejtoreshën e shëndetësisë dhe kërkoj mbështetjen e të gjithëve.Sa i përket informimit,mënyra e informimit shkon sepse ne kemi marrë iniciativa edhe më hrët dhe i kemi mbështetë më se 98 gra të prekura nga kjo sëmundje,me mbështetjen e asambleistëve të kaluar.Vazhdimisht kemi vazhduar edhe me fushata dhe ligjerata se si duhet ta trajtojmë këtë sëmundje.Ju falemderoj për mbështetjen të gjithëve.

Besa Kuçi - pajtohem me Albanin për strategjinë e informimit por mendoj që kjo duhet të jetë më shumë strategji shtetërore.Ka një vit e më shumë që në Ministrinë e Shëndetësisë e kam dërgu një projekt për skringun e qafës së mitrës dhe inkurajoj edhe gratë asambleiste me mbështet në këtë drejtim. Vazhdimisht i kam publiku emailat që ata nuk më kanë kthy përgjigje dhe besoj se këtu dhe grupi i grave ka pas mundësi me reagu dhe me dërgu dhe një kërkesë.Mamografi ka punu por me termine për shkak se ka qenë me një vend me rentgenin dhe tash s' do të jetë me një vend dhe do të bëhen ma shumë mamografi.Në bashkëpunim me organizatën nga Prizreni e kemi bë një listë për grate mbi 40 vjeqare dhe i kemi thirrë por askush nuk ka ardh me bo mamografinë.Pra duhet të jetë një strategji shtetërore në mënyrë që informacioni të shkojë në secilën shtëpi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të ndërhyrjes ndër-sektoriale për ndryshime klimatike për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2028;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që në hartimin e këtij plani kanë marrë pjesë shumë ekspertë dhe për çdo sqarim kemi prezent dy përfaqësues të UNDP-së. Kryesuesi hap debatin.

Selman Kolgeci - sa i përket kësaj pike falemderoj ekipin që është munduar ta jep kontributin e vet në hartimin e planit për ndërhyrje. Tek trajtimi i analizës në sektorin e transportit nuk është pasqyruar gjatësia e rrugëve. Nga kjo marrë shkas që të kërkoj nga qeverisja komunale që të krijoj Data Bazën dhe të ngarkohet i tërë rrjeti i rrugëve të ndërtuara në territorin e Komunës së Suharekës, me gjatësi të saktë, me vit ndërtimi dhe të vendosura në hartografi. Kjo pa dyshim që do ta rriste transparencën që dukshëm është e ulët, e cila është e dëshmuar edhe sipas organizatave joqeveritare në vend. Po e shoh që keni planifikuar

Investime në automjete hibrid e automjete elektrike të përcjellura me infrastrukture përcjellëse. Kjo është një kopje nga plani i programit zgjedhor të LDK-së në zgjedhjet e fundit lokale, megjithatë ju përgëzoj që keni përqfuar planprogramin tone, vetëm se nuk keni planifikuar investime në trotuarin për personat e verbër. Te kjo çështje nuk është paraparë të ndërmerret asnjë masë për uljen e emetimit të gazrave nga automjetet e transportit të mallrave. Pse duhet neglizhuar gazrat që emitojnë ato automjete? Poashtu e shoh që e keni heq kopjen Smart and save City dhe tash e keni vendos Smart City, sepse me një projekt vitin e kaluar e keni nisur për Smart and save por nuk ju ka dal as Smart e as Save. Pra taksat e qytetarëve tanë të destinuara për projekte interesante inovative kanë përfunduar me disa poça ndriçues mbi vendkalimet e këmbësorëve që qeverisja juaj e ka pranuar që ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe sot rrezik potencial për këmbësorët si pasojë e cilësisë së materialeve të përdorura. Në faqen 48 të materialit, tabela 8.4, masa 8.1.2.3 dhe 8.1.2.4, ku për këto pika është kërkuar sqarim nga grupi punues se çfarë është menduar dhe çfarë nënkupton kjo. Tek çështja e ndikimeve në mjedis është përmendur dëmtimi i pyjeve. Pajtojtohem që ka pas dëmtim të madh të pyjeve sikurse pajtohem që është dështim i zotit Muharremaj dhe i qeverisë së tij. Ajo që më shqetëson më së shumti është se a do ta ketë fatin e njejtë edhe ky plan i ndërhyrjes sikurse ai i startegjisë për zhvillim ekonomik të sjellur e të miratuar para disa muajsh në Kuvend.

Enver Shabani - unë jam kryesues i grupit punues dhe në mesin e grupit punues ka pas një thirrje publike ku janë 30 persona nga shoqëria civile, bizneset, ekspertët e fushave të ndryshme, studentë, nxënës dhe të gjithë pjestarët e tjerë, kurse përsipër për me bo planin e ka marrë UNDP e cila ka kontraktuar ekspert të fushave të ndryshme dhe besoj se sqarimet në vazhdim do të na japin koordinatort nga UNDP Merita Koçi dhe eksperti i fushës për efikasitet Maliq Përci, të cilët i falemderoj për kontributin.

Maliq Përci - përshëndet të pranishmit. Përshkruan në pika të shkurtra procesin e krijimit të këtij plani. Te pyetjet, vërejtjet dhe komentet që u dhanë, te sektori i transportit ishte që nuk janë paraqit rrugët. Në verzionin të cilin ju e keni, ashtu është mirëpo prej momentit kur është përfunduar drafti final me grupin punues, ne kemi kërkuar që të marrim miratimin në menaxhmentin e UNDP-së dhe pikërisht një prej vërejtjeve ka qenë kjo e cila në ndërkohë është intervenuar. Në ndryshim është pasur pjesa përshkruese me grafike nga emetimet e gazrave dhe nuk ka ndryshim në plan. Investimet në makinat hibride dhe elektrike thatë që është plani i LDK-së. Ne jetojmë në një shoqëri ku ka shumë ide dhe diskutime por procesi i zhvillimit të këtij plani nuk është bazu në ide të marra prej platformave politike dhe normal që partitë politike kanë ide dhe unë po ndihem mirë nëse kjo është përputh me planin e ndonjë partie politike. Te plani, nëse shikohet është pjesa e tranzitit. Te transporti i mallrave nuk ka vërtet ndonjë plan i cili merret direkt me makinat por dhe kjo është marrë prej Hartës Zonale dhe pjesa e mobilitetit dhe zvogëlimit të ngulfatjes së komunikacionit është në kuadër të masave të zbutjes së emisioneve nga transporti i mallrave. Pjesa e masave të cilat lidhen me transportin e mallrave, ato do të bëhen te plani i mobilitetit i cili është propozu këtu dhe ai është një dokument i rëndësishëm të cilin komuna duhet me pas. Te Smart city dhe Smart and save, ky projekt por edhe të tjera, te plani i veprimtregojnë se është një propozim i ri apo ekzistues. Mënyra se si kemi ardhë te idetë, ka qenë në dy forma. Një formë ka qenë analiza e dokumenteve ekzistuese zhvillimore komunale dhe pjesa tjetër ka qenë diskutimi në grupe dhe marrja e propozimeve

direkte prej anëtarëve të grupit punues. Disa projekte janë marrë prej PZHK-së, disa prej HZK-së dhe disa janë prej strategjive të tjezër që i keni si Komunë. Ato ide janë zhvillu dhe përpunu ose janë vendos në kontekstin të cilat lidhen me ndryshimet klimatike. Për pikat 8.123 dhe 8.124, njëra ka të bëjë me Smart and save dhe tjetra me stacionin e autobusave të cilat janë marrë nga Harta Zonale. U përmend ndikimi në mjedis-dëmtimi i pyjeve. Ky plan është bo në një çasje neutrale ndaj çfarido ndikimi. Kemi raste kur pyjet edhe dëmtohen dhe unë nuk e kisha vendos në kontekstin politik krejt këto që janë në plan, por më vje mire kur idetë që janë këtu përputhen me idetë e ndonjë subjekti.

Selman Kolgeci - ju po thoni që nuk ndryshon në dinamikë çështja e hartës së rrugëve dhe poashtu dhe një vërejtje prej juve Kryesues. Nëse ka ardh brenda dy ditëve, ps nuk na keni përcjell.

Kryesuesi - jo, nuk ka ardhë.

Selman Kolgeci - është dasht me përcjell si material sepse e kemi pa që mungon dhe po thotë që nuk ndryshon në dinamikë. Kë e keni bazë krahasuese për emetimin e gazrave nese si keni rrugët? Qështja e dytë është ndotja nga automjetet transportuese. Në secilën pikë që e keni trajtu, ju jeni thirrë te automjetet e udhëtarëve dhe askund automjete transportuese. Te plani i mobilitetit as kjo nuk është diskutu se cilat janë rrugët më të mira që duhet mi zgjedh automjetet transportuese për me liru më së paku gazra dhe për mos pengesë në komunikacion. Te smart and save city pe shoh që e keni marrë prej HZK-së. Nuk ju ka dal as smart as save dhe çka po doni me bo tash.

Maliq Pereci - ky plan nuk e ka pas për qëllim me i identifiku emetimet të cilat janë duke ndodh në secilin sektor sepse ajo është duke u bo në proces nga UNDP i cili po e mbështet Komunën dhe është i angazhuar me një kompani konsulente e cila është duke bë inventarin e gazrave sere në tërë komunën e Suharekës dhe komunën e Prizrenit. Plani i mobilitetit i regullon redukimin e emetimeve në transport dhe kjo është pika që është vendos në planin e ndërveprimit për ndërhyrje ndërsektoriale për shkak se ky plan nuk e ka pas për qëllim me u ndal në detale në planet e mobilitetit për shkak se plani i mobilitetit është fushë e gjan dhe e cila don analizë të madhe. Për smart and save city është një projekt e cila nuk është e lehtë dhe më vje mire që Suhareka e ka dhënë këtë ide dhe duhet me zhvillu ma tutje. E përmendët pjesën teknike por nuk ka qenë në mandatin tonë dhe ne nuk e kemi trajtu atë.

Selman Kolgeci - nëse s'ka qenë në mandatin e tyre, drejtori që ka qenë kryesues i këtij grupi e din që janë pagu mjete nga taksat e qytetarëve për këtë dhe është dasht me përfshi këtë.

Maliq Pereci - Smart and save dhe Smart nuk është e njejta gjë.

Selman Kolgeci - për mu është kryer Smart and save, është pagu dhe këta le t'ia bëjnë vendin. Këtë është dasht me fut në këtë dokumentacion dhe me cek që është e kryer dhe vetëm me avancu. Drejtor, ju e keni pas një projekt që e keni kopju, por ju bëj thirrje që herave të tjera mos kopjoni nëpër tavolina por ejani dhe merreni idenë sepse jemi të gatshëm me kontribu.

Enver Shabani - në janar të këtij viti Kryetari i Komunës ka lidhë një marrëveshje memorandum mirëkuptimi me UNDP për një bashkëpunim tre vjeqar. Falemderoj Selmanin për vërejtjet, sugjerimet dhe kritikën për këtë projekt dhe i bëj ftesë që të bëhet bashkëpunëtorë, të hyjë në këtë listë dhe të jepë kontributin e vet në fushën e komunikacionit sepse bashkëpunimi ka me vazhdu edhe dy vjet me UNDP-në. Drejtori tutje jep sqarime rreth projektit me UNDP-në dhe projekteve tjera që janë bë dhe që do të bëhen.

Selman Kolgeci - sapo ta thashë që jemi të gatshëm me kontribu dhe jo veq për këtë por për secilin projekt të mire në Suharekë, jo vetëm unë por secili antarë i Kuvendit nga radhët e LDK-së.

Urim Suka - e mbështes grupin punues. Jemi të interesuar apo angazhuar që çdo plan që fillon, të ndërtohet, të implementohet dhe shqetësimet që kolegu ngriti janë shqetësime që ky plan të plotësohet me elemente të nevojshme. Shqetësimi kryesor është që ju sjellni dokumente këtu dhe miratoni dhe kurrë më nuk i qelni, nuk i shikoni se çka thojnë ato për me vazhdu me i implementu ato ide. Sikurse e kemi strategjinë e fundit dhe vazhdon me u punu kundër asaj strategjie. Thirrja ime është që të bëjmë plane sa ma të mira dhe të jenë udhërrëfytes ato dokumente.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

22 për, 1 kundër, 2 apstenime
Miratohet pika 4

Pika shitesë: Projekt-vendimi për miratimin e Hartë Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2023(HZK);

Kryesuesi - pika shitesë të cilën e votuam,e cila ka të bëjë me plotësim-ndryshimin e vendimit të Hrtës Zonale,ku po kërkohet që neni 3.2 të hiqet nga ky vendim.Hap debatin.

Selman Kolgeci - Avniu përmendi diçka por nuk përmendi se a do të jetë PZHK ende aktiv apo jo.Ne e kemi miratu Hartën Zonale dhe e kemi thenë që është dokumenti më i rëndësishë dhe i kemi lënë dy plane rregulluese aktive.Kjo është një paaftësi.Keni mujt me kry vetëm me një telefonatë dhe pa pas nevojë me u shty 1 muaj tash dhe një nuaj tjetër me prit përgjigjen e ministries dhe e pa i dëmtu bizneset që presin për leje ndërtimore.

Avni Bytyqi - ligji i planifikimit hapsinor i njeh tri dokumente:Planin Zhvillimor,Hartat Zonale dhe Planet rregulluese të hollësishme.Grupi që ka punu çështjen e HZK-së dhe firma projektuese së bashku me Drejtorinë e Urbanizmit e kanë pa të arsyeshme që këto dy plane rregulluese të jenë në fuqi për arsye se janë plane specifike.Mirëpo ministria nuk po lejon dhe e kemi sjell me shfuqizu.Asnjëherë nuk ndodh që ekzekutivi me ndryshu apo me korigju një vendim pa e njoftu Asamblenë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ndëlidhem me fazën kur e kam drejtu Drejtorinë e Urbanizmit. Atëherë si grup punues e kemi pa të arsyeshme që këto dy plane me u integru te drafti i HZK-së dhe tani Harta Zonale veq ka ardhë në miratim, nuk është kërku mu shfuqizu ato dy plane rregulluese për arsye se nuk kanë qenë në kundërshtim me HZK-në për shkak se kanë qenë të integruara në HZK,për arsye se ajo pjesë është pronë publike,nuk janë prekur intersat personale por kanë qenë interesat e përgjithshme të komunës,duke marrë parasysh që ato zana janë të licencuara nga MTI dhe është pare e arsyeshme nga grupi punues dhe nga kompania që të integrohen nëHJZK dhe të mbesin në fuqi.Tash kemi ardhë me një pikë ku ose duhet mi lënë ato në fuqi ose HZK-në dhe normalisht që interesi është me u miratu HZK përfundimisht.Në anën tjetër po i shkakton dëm Komunës sepse Komuna tash duhet me rifillu hartimin e planeve të reja rregulluese që merrë shumë kohë,merrë financa,angazhim të stafit.

Urim Suka - dua ta potencoj dhe një here që kërkesa jonë në mbledhjen e kaluar që kjo çështje të shtyhet për një periudhë të shkurt sa ne të informohemi në detaje nuk është marrë parasysh prej jush me idenë që të bëjmë diçka shpejtë dhe të kryejmë punë sepse pop resin qytetarët,por në fakt ju qytetarët i keni vonu edhe një muaj.Ndërroni qasje, ta kemi edhe ne më lehtë për me i ndihmu edhe qytetarëve për këto.Prandaj ne këtë projekt-vendim do ta apstenojmë për faktin që nuk duam të bëhemi pjesë e një paaftësie të juaj për me ngrit këtë qështje.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shitesë.

**13 për,9 apstenime
Miratohet pika shitesë**

Pika 5. Informatë financiare për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Shator 2022;

Kryesuesi - elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - pak më shqetëson situata kur kjo informatë ka ardhë dhe Krytarin nuk e kemi këtu.Unë besoj që Kryetari ka me bo praktikë që edhe në seanca tjera me na mungu për shkak se e ka të vështirë me u ballafaqu me faktet që ne për çdo Asamble po i ngrisim.Para vetes e kemi raportin e shpenzimeve për buxhetin janar-shtator 2022, i cili raport e vërteton atë që unë them në vazhdimësi për këtë pushtet.Pra keqplanifikim,keqmenaxhim të parasë publike në secilin projekt.Ky pushtet për 9 muaj ka arrit të shpenzoj vetëm 38 % të buxhetit për investime kapitale.Rrjedhimisht kjo do të thotë që 62% e këtij buxheti nuk është shpenzuar dhe kjo shumë duhet të shpenzohet për tre muajt e fundit.Kjo mënyrë e shpenzimit të parasë publike nuk sjell zhvillim për Komunën tone.Unë dua të ju bëj me dije që ne si opozitë do t'ju përcjellim me vëmendje shpenzimet që ju do të bëni,me theks të veçantë këto muajt e fundit dhe do të adresojmë çdo keqpërdorim që ju bëni me qëllim të parandalimit të tyre.Kërkoj sqarime rreth shpenzimeve që ju keni bërë.Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike figuron që janë shpenzuar 66.339.000 euro për furnizimin me

rrymë-gjenerator.Kjo për mua është e paqartë pasi për shpenzimin e rrymës i keni deklaruar 126.000 euro.Gjithëashtu kërkoj sqarime për shpenzimet që janë bërë për udhëtimet zyrtare jasht vendit.Në Drejtorinë e Shëndetësisë 260.000 euro për shpenzime shëndetësore.

Kërkoj të di se për çfarë shpenzime shëndetësore bëhet fjalë.

Selman Kolgeci - siç e kemi thënë kur është raportuar administrimi i buxhetit janar-qershor në Korrik,rezultat dekorajues ka qenë atëherë, e akoma më dekorajues tani. Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike tek të hyrat buxhetore, nga 59 projekte për ndërtimin e rrugëve dhe infrastructures të buxhetuara për vitin 2022,afër 20 projekte nuk e kanë shpenzuar asnjë cent të vetëm për 9 muajt e kaluar.Ndërsa tek të hyrat vetanake nga 41 projekte për ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturës në përgjithësi,në 25 projekte nuk ka as një investim për 9 muajt e shkuar.Në Drejtorinë e Bujqësisë nga katër projekte që financohen nga të hyrat buxhetore,vetëm në dy prej tyre kishte progres por me një përqindje shumë të ulët,ndërsa nga të hyrat vetanake për këtë drejtori, nëntë muajt e shkuar nuk kishte progres në tri projekte të buxhetuara.Në Drejtorinë e Kulturës nga shtatë projekte të buxhetuara,vetëm në njërin ishin shpenzuar afër 9 mijë euro.A ka punu drejtoresha online apo ka qenë me korrespondencë sepse 9 muajt e fundit është skandaloze të shohim një administrim të tillë të buxhetit.Në Drejtorinë e Arsimit si zakonisht kishin punuar gjykatat.Shpenzimet sipas vendimeve të gjykatave për nëntë muajt e fundit janë 894,566.029 euro

dhe ne e kemi thënë se pse s'po zbatohet kontrata kolektive por po e dëmtoni buxhetin në këtë formë.Drejtor Bajselmani,kam kërku edhe më herët dhe të lutem që brenda afatit të paraparë ligjor me ligjin për qasje në dokumente zyrtare,ta kompletioni listën se sa nga këto shpenzime kanë shkuar për punëtorët e arsimit,sa për shpenzime të gjykatave,sa për përfaqësime të avokatëve dhe sa për taksa të

përmbaruesëve.Në disa projekte keni thënë se janë investuar mjete dhe në ato projekte kemi ngritur shqetësime të vazhdueshme se ato rrugë janë të ndërtuara.Rast konkret është ndërtimi i rrugës Amërllah Hoxha dhe Kolonjat në Peqan.Keni raportu se i keni investu 24,645.05 euro.Si i keni investu ato mjete me një rrugë që është ekzistuese?Raste të ngjashme ka akoma më shumë.Në zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës te Antena në Vraniq i keni shpenzu 49,430.00 euro ndërsa në teren nuk e keni vendos asnjë metër katror asfalt.Shqetësim tjetër është shtyerja e investimeve kapitale në tre muajt e fundit zakonisht po rezulton me punime jo kualitative,të manipulueshme në aspektin e kuantitetit dhe kjo po i ekspozon shërbyesit civil që ta shkulin ligjin.

Besa Kuçi - Shërbime të ndryshme shëndetësore është projekti Karitas dhe Hendikos,ku me këtë kod paguhen këto dy projekte.

Urim Suka - te projekti Karitas dhe Hendikos,a mundeni me sqaru se sa participon Komuna dhe sa Karitasi?Çfarë përfiton Komuna në këtë rast prej Karitas,a ka mjete që vin edhe prej tyre apo janë buxhet i Komunë?

Besa Kuçi - këto mjete të cilat ishin janë buxhet i Komunës.

Ardian Kotorri - përshëndet të pranishmit.Janë shqetësime që vërtetë janë me u ngrit.Për ndërtimin e serave vlera e projektit ka qenë 96.000.Ne e kemi nis procedurën tenderuese dhe kanë qenë dy kompani që kanë ofertu.Zyra e prokurimit e ka shpall më të lirin,pastaj kompania e ka bë rivlerësimin dhe e ka dërgu në OSHP dhe prap OSHP e ka shpall më të lirin.Tani jemi në procesin e ndërtimit të tyre.Unë besoj që është mirë me u bo shpenzimet por nganjëherë dalin dhe probleme rrugës.Projekti për subvencione është në përfundim e sipër.

Selman Kolgeci - te qështja e prokurimit nuk kërkohet më i liri por më i liri i përgjegjshëm.

Ardian Kotorri - OSHP-ja ka vendos atë që e ka shpall Komuna për here të parë.

Selman Kolgeci - kërkoj sqarime për projekte tjera.

Ardian Kotorri - ne e kemi përmbyll një fazë të rrugëve fushore,jemi në përfundim dhe të një kanali në Samadraxhë.Kemi pas disa pengesa pronësore por besoj e kemi zgjidh me mirëkuptim me banorët atje.Deri në fund të vitit shpenzimi do të bëhet ashtu si është planifiku.

Enver Shabani - unë nuk pajtohem me Urimin që thotë se janë shpenzu vetëm 38 % të shpenzimeve kapitale por nuk pajtohem as me Selmanin që thotë se vetëm 30 projekte nga 50 kanë fillu.Drejtoria e Shërbimeve Publike deri më tani ka shpenzu 46 % të buxhetit për investime kapitale.Komuna e Suharekës para qershorit nuk ka mundur të shpenzojë asnjë cent sepse ju e dini që buxheti ka kalu me vonesë.Të gjitha shpenzimet që kemi bo janë për tre muaj dhe ju garantoj që edhe pjesën tjetër do ta shpenzojmë varësisht

nga punët që kryhen në teren,por kam besim që këtë vit 98 % e planit do të realizohet.Te rruga Antena,është e vërtetë që ka dal në tender dhe nuk është investu por paratë tjera kanë shku në Vraniq.Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - unë në disa seanca kam thënë që ju materialet që i sillni, nuk i lexoni vet.Unë fola për ato dokumente që na keni sjell ju.

Enver Shabani - nuk janë për nëntë muaj.Ju e dini që s'kemi bo asnjë shpenzim deri në maj.

Urim Suka - as një shpifje nuk jam duke e bo,jam duke u thirr në dokumentin që u sjellë.

Nënkryetarja - sa i përket mungesës së Kryetarit,Kryetari ka mungu sepse ka tre takime të një pas njëshme në Prishtinë.Kryetari ka qenë vazhdimisht prezentë në Asamble Komunale.Sa i përket shpenzimeve të udhëtimeve zyrtare,të gjithë e din që këto janë të përcaktuara me ligj.Nënkryetarja tutje jep sqarime dhe thotë që është edhe dokumentacioni dhe mundemi me ti dhënë edhe me shkrim.

Selman Kolgeci - këto numra që i kam nxjerr si projekte numerikisht,bëjnë 45 projekte që nuk ia ke nis fare.Ose nuk ke filluar fare ose ka ni progres të vogël në zbatimin e projekteve.Për rrugën te Antena,thatë që mjetet kanë shku në Vraniq.Vraniqi ka mbi 550 shtëpi dhe në cilin oborr ka përfundu ai safalt.The që 20 herë e kemi diskutu rrugën "Emërllah Hoxha" dhe "Kolonjat".A prapë po paguani për atë rrugë?

Enver Shabani - për të hyrat vetanake pak po të jap të drejtë,kurse mos thuaj 30 projekte nuk kanë fillu.

Ju informoj që Komuna për herë të parë këtë vit ka lidh kontratë dy vjeqare dhe si rrjedhojë kuptohet që asnjë euro nuk ka me shku suficit.Drejtori jep sqarime për rrugën "Te Antenat" dhe rrugën "Emërllahu".

Selman Kolgeci -për që s'kan me shku suficit kujdeset gjykata,sepse deri tani gati 1 milion na i ka marrë.

Remzi Bajselmani - është temë mjaft e komplikuar,jo vetëm në Suharekë.Nuk kemi të bëjmë ne me kontratën kolektive si Komunë por është kontratë që është lidh mes qeverisë së Kosovës,sindikates së arsimit dhe sindikatës së shëndetësisë.Ne do të kujdesemi për këtë listë e cila është e përzier bahkë me të shëndetësisë,por bashkë me zyrtarët financiar do ta gjejmë se çka është shpenzu dhe ka kanë shku.Drejtoria e Arsimit nuk e din se ku janë duke u marrë ato mjete,kush është duke u dëmtu.Asnjë projekt i joni nuk është ndal dhe asnjë person nuk është dëmtu për paga dhe meditje.

Lorika Gashi - përshëndet të pranishmit.Kush do që e ka përfundu një shkollim univerzitar,e din që një fakultet i cili përmban praktikë nuk mundet me u mbajtë me korrespondencë.Drejtoria e Kulturës ka mjaftueshëm praktikë sa që s'mundet gjithë stafi i drejtorisë me i përfundu dhe me arritë gjitha praktikat që i ka.Sa i përket online,nuk ka asgjë të keqe edhe të mbahet online.Sa i përket informatave,jemi të nejtat procedura,të nejtat vija.E keqja është se në drejtorinë time nuk kam një inxhinier dhe një financier të cilët munden me më ndihmu dhe me më drejtu,atëherë unë duhet me gjet mbështetje dhe lutje te drejtoritë tjera dhe shkon pak me vonesë,por punët janë duke u bë në teren dhe procedurat janë duke përfundu.

Selman Kolgeci - unë nuk e kisha hallin a vje online apo me korrespondencë.Online dhe me korrespondencë ka rezultu në zyrën e vet. Në 6 projekte ke dështu dhe vetëm një projekt e ke hargju prej 9 mijë eurosh për 9 muaj.

Lorika Gashi - sa i përket akrobacioneve,ne e kthejmë abrokacionin me abrokacion.Sa i përket zyrës, asnjë drejtor nuk është i thirrur me qëndru 8 deri 4 në zyre,dhe a kam dështu apo jo,ai që m'ka thirrë me përfundu punën,ai e ka edhe mandatin dhe të drejtën me më shkarku.

Flamur Bytyçi - po e shoh një shpenzim të madhë te dreka dhe darka.Drejtoresha tha që s'kam ekonomist.Unë besoj që je ekonomiste shumë e mire me këtë shpenzim 6500 euro.Nëse s'ke ekonomist për punë tjera,pse pate ekonomist për këtë shpenzim?Kërkoj një raport të drekave dhe darkave për mbledhjen e ardhshme.

Lorika Gashi - patjetër që do ta keni një raport për shpenzimin e drekave dhe darkave zyrtare.

Labinot Halitjaha - përshëndet të pranishmit.Buxheti është vonu dhe ka ardhë në muajin maj.Për me u zhvillu një procedure në prokurim vonon një muaj dhe ka fillu me u ekzekutu në qershor.Pra janë tre muaj dhe jo nëntë muaj.Është ekzekutu 38 % ndërsa te granti qeveritar 45 %.Te pjesa e drekave dhe darkave zyrtare në Drejtorinë e Financave është se Komuna ka shkuar në Shqipëri.

Alban Berisha - jam i fasionum dhe kënaqëm kur jepni përgjigjet kur t'ka naj dështim.Shyqyr që ekziston qendra.Çka me bo,mu bo naj decentralizim,mos me pas nevojë për buxhetin qëndror për këto alokime dhe kisha pas dëshirë të di se çfarë arsye do t'kishit dhanë atëherë?

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - hap debatin për këtë pikë.

Dardan Berisha - pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: vendosja e pahive mbrojtëse në aksin rrugor Autostradë-Zonë Industriale në të mire të qytetarëve. Drejtoria e Arsimit: Pse për qerdhe e hapura për fëmijë nuk ka pediatër? Të kontrollohen fëmijët nëpër qerdhe së paku 2-3 herë në muaj. Kërkoj nga Drejtori i Arsimit të di se si është e mundur të zhvillohet ky aktivitet në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë.

Enver Shabani - rruga ka përfunduar pothuaj para dy viteve, mirëpo nuk ka qenë në paramasë pahija nga projektantët. Para disa javë kemi bë kërkesë në ministrinë e Infrastrukturës për të na ndihmuar në vendosjen e pahive elastike, mirëpo nuk kemi ndonjë përgjigje.

Dardan Berisha - nëse përgjigja është negative?

Enver Shabani - nëse përgjigja është negative, Komuna duhet të mbledhë forcat e veta dhe të gjejë një buxhet ose fond për rregullimin e pahive, sepse vërtet është e pa tolerueshme.

Remzi Bajselmani - në organogramin e të punësuarve në Komunën e Suharekës nuk është i parapare një pediatër për qerdhe deri më tani. Në të ardhmen me kalimin e qerdhes së madhe që do të bëhet në qytet do ta shohim mundësinë për organizimin e ri të punëtorëve dhe për pediatër.

Urim Suka - këtu e kam kontratën e rrugëve që janë shtrur në fshatin Peqan. Këtu shkruan që gjatë këtij viti ju keni planifikuar të shtroni rrugën “Emërllah Hoxha”, “Kolonjat” dhe “13 Korriku”. Unë i pash këto rrugë. E vërteta e këtyre rrugëve është se rruga “Emërllah Hoxha” dhe “Kolonja” janë të shtruara në vitin e kaluar ndërsa rruga “13 Korriku” nuk ishte e shtruar fare. Si ka mundësi që ju keni shpall tender, keni vlerësuar ofertë, keni shpall fitues, keni nënshkruar kontratën por rrugët nuk i keni shtrur asnjërin? Ndërkohë gjatë vizitës në Peqan, pashë që kanë nevojë të shtrohen shumë rrugë, si: Lulëkuqja e Kosovës, Guri i Mullirit, rr. te Fabrika e Tekstilit, rr. Longari, rr. Frank Bardhi dhe të cilat janë rrugë të gjata dhe ishin shqetësuar për banorët atje. Kërkoj sqarime se çka ka ndodh. Për shqetësimet në fshatin Bllacë: pse nuk është shtrur rruga “Ymer Krasniqi” e cila është kontratë për këtë vit? A mund të më njoftoni pse nuk është bërë sanimi i kanalizimit në qendër të fshatit dhe kanalizimi që vjen nga lagjja Zekolli dhe kalon nga lagjja Lumi dhe kalon deri në fund të fshatit. Këta banorë shqetësimin e kanë ngritë edhe te ju dhe nuk është zgjidh kjo çështje edhe pse ekziston një kontratë për këtë çështje. Gjithëashtu në Bllacë kam marrë shqetësim prej disa banorëve për shkarkimin e ujërave të zeza të fshatit në pronat e tyre private. Kërkoj nga ju që ti dërgoni ekspertët e drejtorisë tuaj dhe ti jepni zgjidhje këtij problem duke planifikuar largimin

e ujërave të zeza nga pronat private dhe ndërtimin e një miniimpianti. Në Bllacë keni ndërtuar një kënd lojërash dhe aty kam marrë shqetësime prej qytetarëve për kualitetin e punës. Shqetësimi ka të bëjë se kablla e shtyllës elektrike është pothuaj mbi to dhe unë mendoj që mundet me rrezikun jetën e njerëzve e sidomos fëmijëve aty.

Enver Shabani - shqetësimi juaj për rrugën “13 Korriku” është me të drejtë, por aty ka pas problem nga banorët e vet lagjës, dhe aty kemi pas problem me bartjen e ujërave atmosferike, andaj dhe e kemi bartë si projekt. E njejtë paramasë por jo me të njejtin emër ka shku në Peqan të Vogël. Sa i përket kanalizimit në Bllacë, kemi bë sanime, intervenim dhe ndërtim të kanalizimeve të reja rreth dy kilometra. Pajtohem që gjendja është si thua ti por nuk kemi më shumë kapacitet dhe mundësi të merremi me sanimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve. Edhe pse po derdhen ujërat në livadhe te Biraqi që the, aty nuk po lë dikush tjetër me depërtu sepse kemi qenë të interesuar në zgjidhjen e atij problem. Është bë një kënd i lojërave në Bllacë por në këtë rast nuk ka qenë projekti i D.Sh. Publike por ka qenë projekt i kultures dhe nuk kam informata se çka u bë. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - unë dua të di pse nuk është shtrur rruga kur është e lidhur kontrata. Te impiantet, unë po flas për Bllacë ku janë dëmtuar pronat private në përgjithësi dhe është emërgjente që ju me shku me pa për mundësitë e zgjidhjes së asaj çështje.

Kushtrim Kuçi - e ka vendosur Kryetari rrethrotullimin me foto. Tregon shqetësimin e tij me foto, te rruga e stacionit të autobusëve. Tregon dhe një shqetësim me foto për rrugën mbrapa mullirit në Shirokë e cila ka mbi 40 shtëpi. Te lagjja Sllogja ka shumë pjesë të trotuarit që nuk janë të shtruara. Është në pyetje një investim shumë i vogël dhe është lagjja më e organizuar në qytet. Problem tjetër është edhe papastërtia në qytet, edhe pse nuk e mendoj përkushtimin e Komunës por po mungon vetëdijësimi i qytetarëve. Lus

Drejtorinë e Inspeksionit,që aty ku nuk ka pastërti me dal me vendos gjoba.Fenomen tjetër është se prap kam vërejtë që autobusët që kalojnë nëpër rrugën Hajdin Berisha nuk ndalen në stacion të autobusëve.A ka rezultat për këto takime që po i mbajmë?Me tatimet tona paguhet drejtori i Stacionit të Autobusave dhe anëtarët e bordit dhe prap i njeiti avaz.Në shtëpinë e Felbahut ,me Drejtorin e Sh.Publike kemi qenë të pranishëm,ku kemi pa një fim me metrazh të shkurtër,ku as zërim s’ka pas atje.Të gjitha këto kërkojnë pak investim por janë shumë imediate.

Kryesuesi - rrugën te Mullini në Shirokë,vitin e kaluar kemi insistu me shtru mirëpo ka qenë një kontest gjyqësor dhe figuron në emër të x personit.Për trotuaret te lagjja Sllogja është shqetësuese dhe duhet me u rregullu.Te pastërtia në qytet, kompania Eko Regjion çdo ditë mban pastërtinë por ne vet nuk jemi të ndërgjegjshëm që me mbajmë pastërtinë.

Kushtrim Kuçi - për atë arsye thashë që Drejtoresha me dal çdo ditë dhe me dhënë dënime deri sa të vetëdijesohen.

Kryesuesi - sa i përket autobusave që qarkullojnë në rr. “Hajdin Berisha”,i lejohet kurse ata që janë në vija të rregullta,e kanë obligim me hy në stacion.

Elmaze Bytyqi - ka të bëjë me çështjen e ndërtimeve në zonën kadastrale Delloc-Gradanc dhe Bukoshi 2. Kemi parë aksione të shumta të ndërmarra nga prokuria e shtetit për ndërtime pa leje ndërtimore në Brezovicë.Dua ta di nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoresha e Inspeksionit se a kanë marrë ndonjë nismë për informimin e qytetarëve që kanë ndërtuar apo janë duke ndërtuar villa në zonën në fjalë ,se mund të ketë edhe një aksion të tillë aty.Poashtu dua të informohem se nga ato ndërtime, sa leje ndërtimore posedojmë? Pse kanë ngecur procedurat për fillimin e punimeve për funksionalizimin e Zonës Industriale në Duhël,duke marrë parasysh që një numër i madhë i bizneseve janë në pritje të hapsirave për fillimin e investimeve që do të kishte impakt direkt në zhvillimin ekonomikë të Komunës tonë?

Visar Kuçi - është problem pjesa e Dellocit,Gradancit për ndërtimet pa leje,sidomos pjesa e Gradancit është pjesë e parkut dhe nuk është kompetencë e jona.Delloci është një pjesë e Komunës dhe nuk them që nuk ka ndërtime pa leje,ka.Ministra na ka ndalu me e zhvillu zone turistike dhe na ka kthy disa herë.Kurse më e dëmtuar është pjesa e parkut dhe për fat të keq ministria nuk ka asnjë bashkëpunim me ne për këtë çështje.Sa i përket pjesës së Duhlës,është duke u punu një projekt,ka procedura deri në licencimin e zonave.Drejtori tutje jep sqarime.

Jehona Rrafshi - pyetje D.Arsimit: A jeni në dijeni që në shkollën “Ramë Bllaca” në Bllacë paralelja parafillore vijon mësimin me dy grupe të përbashkëta për shkak se mësuesja e njërit grup gjendet në pushim të lehonisë.Pse nuk është bërë zëvendësim i mësueses?Për fat të keq mësuesja e cila ka mbajmë dy grupe tani gjindet në pushim mjeksor.

Remzi Bajselmani - jam i informuar me rastin,mirëpo informata ka ardhë pak me vonesë,mirëpo vazhdimisht kanë thënë që nuk do të ketë fëmijë shumë. Pra një edukatore ka mujt me punu me këtë grup fëmijësh. Ne kemi bërë përgaditjet për shpalljen e konkursit.

Jehona Rrafshi - kam informacion që psikologja mban mësim me këta fëmijë.A ka të drejtë ligjërish?

Remzi Bajselmani - drejtoresha e ka angazhu një person i cili është më i lirë,por jo me zëvendësu për punën që bën edukatorja.

Mevlude Kabashi - kërkesa më është adresuar nga prindërit e nxënësve të shkollës Naum Veqilhargji në Mohlan.Ata kërkojnë një nënstacion për fëmijët e tyre të cilët pas përfundimit të procesit mësimor janë të detyruar të presin mbi 20 min. autobusin.Kërkesa e dytë është nga disa banorë të Suharekës për rrugën e Tranzitit afër Podrumit.Kjo rrugë është shtruar vetëm me zall dhe është e nevojshme të sanohet sa ma shpejtë sepse kjo rrugë është shumë e frokuentuar.

Kryesuesi - për nënstacionin ke plotësisht të drejtë.Kompania e ka marrë përsipër me kry punimet,mirëpo jemi në pritje të përgjigjes edhe për fshatin Krushicë e Poshtme,në mënyrë që të bëhen të dy nënstacionet.

Enver Shabani - sa i përket rrugës,ka qenë e preferuar nga ingjimerët që rruga disa javë me pushu dhe shumë shpejt do të rregullohet.

Flamur Suka - rruga kryesore në fshatin Peqan, ka dy javë që janë të hapura gropat.Pse po i hapni gropat dhe nuk vazhdoni me punu por i leni dy javë të hapura ku rrezikohen edhe banorët?Drejtorisë së Inspeksionit: A ka mundësi me na informu drejtopreshë se sa inspektime i ke bë deri tash prej se e ke marrë detyrën duke u lidh te Visari që tha që ka ndërtime pa leje në Delloc,Gradanc.

Visar Kuçi - rruga e Peqanit është fakt që është vonu sepse kur i kemi hap gropat kemi has në disa probleme në hyrje të Peqanit dhe para tunelit. Drejtori tutje jep sqarime.

Albulena Kokollari - përshëndet të pranishmit. Në drejtorinë time i kam katër sektorë dhe prej që kam ardhë i kam bërë dy raporte, mirëpo nuk i kam mbledhë të gjitha inspektimet me një raport. Në seancën e radhës do të kujdesem që ti kem të gjitha raportet.

Urim Suka - me që qenka menaxher te parku, le të intervenojë shpejtë sepse gjendja është shqetësuese. Te Kontratave dy vjeqare, në një vit ku çmimet janë trefishu, ju bëni kontrata dy vjeqare dhe me siguri kjo ka me qenë kosto e madhe për komunën vitin tjetër.

Visar Kuçi - jep sqarime rreth kontratave dy vjeqare.

Alban Berisha - te shkolla Profesionale në Shirokë, a keni mendu me marrë masa ndonjëherë që me u shfrytëzu nënkalmimi në Shirokë? Aty është rrezik i madh për fëmijët dhe duhet me marrë masa. Kisha propozu që me bisedu me drejtorin e shkollës dhe me nis një fushatë sensibilizuese brenda shkollës dhe do të ishte mire që kur janë ndërrimet me qëndru edhe ndonjë polic aty.

Kryesuesi - shqetësimin tend ia kisha adresu nënkryetares për shkak se i mban takimet e sigurisë me LMT dhe komandantin e policisë.

Nënkryetarja - do ta kem parasysh dhe javën tjetër në takimin e sigurisë do ta paraqes këtë shqetësim.

Visar Kuçi - ajo pjesë është shumë e ndieshme. Ajo pjesë do të trajtohet me rrethoja urbane.

Urim Suka - shefi juaj ka premtu me siguri transportin për shkollën Profesionale dhe Suharekë. Një prej zgjidhjeve është me ia siguru transportin atyre fëmijëve atje.

Selman Kolgeci - pyetje Drejtorisë së Kulturës: do të doja të di më shumë rreth fshehjes së dokumenteve zyrtare që drejtorja juaj së fundi ka bërë dhe do të doja të di dhe qëllimin e kësaj ndodhie.

A mund të më tregoni më shumë për refuzimin që iu është bërë juve si drejtori nga artistët e qytetit tonë për arsye se ju keni vendos mos me iu dhënë mbështetjen e duhur këtyre artistëve, por ndihma apo lëmosha institucionale. A je në dijeni se për këto veprime nuk është mbajtur java e artit në Suharekë ?

Në thirrjen e drejtorisë që ju e drejtoni, për subvencione, a është specifikuar që përfitues mund të jenë vetëm ato OJQ që operojnë në Suharekë apo edhe OJQ të komunave tjera por që aktivitetin e kryejnë në Suharekë. Nëse në thirrjen e specifikuar se përfitues mund të jenë vetëm ato OJQ nga Suhareka, a ka pas përfitues nga komunat tjera? Nëse po, pse? Drejtorisë së Urbanizmit: Eprori juaj ka thënë që kudo që ka kontest gjyqësor unë nuk investoj dhe e largoj investimin prej aty. Po ndodh ndërtimi i sallës sportive në shkollën e mesme "Skender Luarasi" në Suharekë. A ka leje ndërtimore ai projekt? Nëse po, në emër të kujt është? Nëse është në emër të personave privat, si ka mundësi Komuna me investu në prone private? The që ka kompani që po kryejnë punë dhe i kam ndal dhe si kam lëshu pagesa. Të lutem mos e bëj atë veprim.

Visar Kuçi - të lutem mos e keqtrajto. Dal në teren dhe i mas sasinë dhe atëherë vendosim.

Selman Kolgeci - nuk jam duke e keqtrajtu, por po them që nëse ka kry punë një kompani, verifikoja dhe nënshkruja.

Selman Kolgeci - Enver, the që është investu në kanalizimin në fshatin Vraniq. Është e vërtetë që është bo ky projekt nga emra të njohur e të respektuar, por pikërisht për atë projekt kemi pas ankesa dhe ju po e merrni si referencë të mire një projekt që ka dështu.

Nënkryetarja - për fshehjen e dokumentave të grupit të artistave. Unë këtu do ta ngris zërin kundër veprimeve të cilat i ka bërë artisti në fjalë. Ka qenë ofenduese jo vetëm për drejtoreshën por edhe për të gjitha neve grave me fjalorin të cilin ai e ka përdor. Është e papranueshme dhe të gjithë duhet ta dënojmë këtë akt. Se a janë fsheh ato dokumente, të gjithë e dime se pse nuk ka kalu ai vendim.

Selman Kolgeci - unë nuk e mbështes apsolutisht reagimin e artistit, vetëm pyeta për fshehjen e vendimit.

Lorika Gashi - për pjesën e parë se kush ka dal në mbrojtje dhe kush s'ka dal në mbrojtje, flasin organizatat e huaja që tash i kanë publiku statistikat se sa gra ndihen të përfaqësime në Kosovë politikisht. Janë 3 % e grave që njihen të përfaqësuara në politikë dhe arsyeja është sepse njerëzit përdorin gjuhë fyese dhe jeni ju ata të cilët na ndaloni me vepru si gra, është gjinia e kundërt, në përgjithësi dhe jo në rastin tim. Me nënshkrimin tim asgjë nuk kalon e cila rrezikon diçka për të cilën unë jam e vetëdijshme. E keni bo kërkesën e vendimit ju Asambleja pa qenë unë, ju ka refuzu ministria. Kanë ardhë me pretendimin që është dikush i cili do të na përkrah në Ministri që ta bëjmë një memorandum bashkë me Felbahun dhe me qendrën rinore dhe me atë memorandum me themel teatrin. E kemi hartu atë memorandum bashkë me zyrtaren dhe e kemi

nënshkru bashkë me Felbahun.E kemi dorëzuar në ministri,mirëpo përgjigja kuptohet që është kthyer refuzim sepse Qendra Rinore e Felbahut nuk i plotëson kushtet.Drejtoresha tutje jep sqarime rreth kësaj çështje.Sa i përket fshehjes së dokumentit,dokumenti nuk është fsheh asnjëherë.Duhet të bëhet kërkesa me shkrim,dhe duhet të shkohet në arkivë

Flamur Bytyqi - më vjen keq për gjuhën që e kanë përdorë.Unë e kam pa që s'ke pas mbrojtje,duke u nis prej partisë tuaj,kolegëve tuaj,Kryetarit dhe grupit të grave.Te çështja e dytë është që unë e kam përcjell me shumë vëmendje kur është bo inicimi i kërkesës për themelimin e teatrit dhe disa prej asambleistëve të LDK-së e kanë kundërshtuar duke e ditë që kjo është e jashtëligjshme.E njëjta është te punëtorët e administratës.

Selman Kolgeci - te çështja e dënimit,normalisht e denoj edhe veprimin e tij,edhe mos veprimin e subjektit tend,grave edhe neve ndoshta.Te çështja e teatrit,nëse s'ke pas mbështetje ligjore,pse e ke provu?Unë atë vendim as sot nuk po shoh dhe kur të bëhen 15 ditë,ka me ardh me marrë në zyrën tënde.Dhe ju si po më adresoheni mua,unë nuk jam avokat i askujt,thjesht dua ta di pse është fsheh ai vendim.

Lorika Gashi - sepse nuk ka qenë një vendim por ka qenë përgjigje prej ministrisë.Atë përgjigje askush nuk e ka kërku zyrarisht,por ai ka pretendu që e ka kërku zyrtarisht. Te java e artit ,nuk kam pas asnjë kërkesë apo projekt.Sa i përket OJQ-ve,rregullorja e thotë që OJQ-të mundën me u subvencionu vetëm nëse projektin e implementojnë në atë Komunë.Kanë qenë dy OJQ të cilat janë me lokacion në Prishtinë dhe Prizren dhe që pritet që ti implementojnë në qytetin tone.

Selman Kolgeci - kerkoj raportin se kush e ka kryer punën prej këtyre dhe kush ka marrë para.

Lorika Gashi - po patjetër.

Visar Kuçi - sa i përket shkollës teknike,nuk kanë kontest komplet parcelat,por një 5 ari ka kontest.Drejtori tutje jep sqarime.

Selman Kolgeci - a ke lëshuar leje ndërtimore për atë objekt? Nëse po,a është prona e Komunës apo prona është individuale?

Visar Kuçi - të tregova që aty nuk ka kontest,por është një pjesë rreth 500 metra katrorë.

Selman Kolgeci - unë po të them që ajo pronë është komplet në emër të familjes Kryeziu dhe ti e din.

Visar Kuçi - unë e kam pas përfaqësuesin e familjes Kryeziu në takim.Ai nuk e konteston pjesën tjetër që iu ka marrë,e konteston 5 ari. Dhe normal që është pa leje sepse nuk i plotëson kushtet.

Selman Kolgeci - nëse është pa leje atëherë pse po ndërton sallën?

Visar Kuçi - zyrtarisht unë kam lëshuar leje në shkollën "Destan Bajraktari" dhe në Hendikos.

Enver Shabani - Projekti i kanalizimit në Vraniq ka pas një projekt detal dhe ka qenë i projektuar nga ekspertë dhe i mbikqyrur nga ekspertë të caktuar.Nuk di çka duhet me bo ma tepër.Megjithatë kemi bërë intervenime.

Takimi përfundoi: 13:50

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj